

**RELACION TEKNIK
PER
OBJEKTIN “ LINJE DERGIMI E FURNIZIMI,RIKONSTRUKSIONI I STACIONIT TE
POMPAVE,DEPO E RE, UJESJELLESIS I FSHATIT SHEQERAS ”**

Projektuesi per hartimin e projektit “LINJE DERGIMI E FURNIZIMI,RIKONSTRUKSIONI I STACIONIT TE POMPAVE,DEPO E RE, UJESJELLESIS I FSHATIT SHEQERAS ” u mbeshtet ne dokumentacionin perkates te vene ne dispozicion nga porositesi dhe materialin satelitor,harten dixhitale dhe matjet topografike ne terren nga grupi i projektimit.

1. Detyra e projektimit.
2. Harte Sh-1:25000 e zones
3. Harte ne shkallen 1:1000 e vitit 1980.
4. Harte dixhitale e fshatit e vitit 2015.
5. Pamje satelitore e zones Qershor 2015.
6. Gjendja aktuale e furnizimit me uje
7. Te dhenat demografike te popullsisë.
8. Matjet topogjeodezike te kryera ne terren.
9. Matja e prurjes te puseve ne muajin Tetor 2018.
10. Normat e projektimit per konsumin ditor.

Njekohesisht per hartimin e projektit u perdoren KTP,KTZ dhe Standartet ne Republiken e Shqiperise.

Normat e projektimit.

- ✓ Popullsia 2630 banore
- ✓ Numuri i femijve ne shkolle 255
- ✓ Numuri i bisneseve 20
- ✓ Rritja natyrale e popullsisë 10 banore/vit
- ✓ Rrjeti i brendshem i ujesjellesit ne gjendje pune
- ✓ Rrjeti i kanalizimeve te ujrave te bardha –mungon.
- ✓ Rrjeti i kanalizimeve te ujrave te zeza i perfunduar.
- ✓ Konsumi ditor i ujit te pijshem 170 l/banor.
- ✓ Kuotat e perdorura-Absolute

Gjate hartimit te projektit u morr parasysh pozicioni gjeografik, perberja gjeologjike e bazamentit,niveli i ujrave nentokesore, gjendja e infrastruktures rrugore dhe kanalizimeve,perberja demografike e popullsisë ,numuri i lindjeve ne vit.

Fshati ndodhet ne veri-lindje te qytetit te Maliqit ne kuoten nga 815 m,shtrirja Lindje-perendim 800 m dhe veri-jug 1000 m.

RRJETI I JASHEM.

Aktualisht fshati Sheqeras furnizohet nga dy puse shpimi qe ndodhen rreth 1 km ne veri te fshatit Sovjan.Nga te dy puset garantohet nje prurje prej 5 l/sek.Uji mblidhet ne nje stacion pompimi dhe percillet per ne depon e ujit Sheqeras nga nje pompe me fuqi 4 KW.

Nga depo e fshatit Sheqeras uji shperndahet ne fshat nepermjet 3 pompave.Dy pompa me fuqi 7.5 KW dhe nje pompe me fuqi 2.2 KW.

Zgjidhja ne kete menyre nuk garanton furnizimin e fshatit gjate 24 oreve dhe njekohesisht ka kosto te larte si pasoje e perdorimit te energjise elektrike.

Fuqia totale e pompave qe perdoren eshte:

Ne fshatin Sheqeras $2 \times 7.5 \text{ KW} = 15 \text{ KW}$
 $1 \times 5.5 \text{ KW} = 5.5 \text{ KW}$
 Pompa derguese Sovjan $1 \times 4 \text{ KW} = 4 \text{ KW}$
 Pompe pusi 2.2 KW
 Fuqia totale 26.7 KW
 POMPAT QE DALIN JASHTË PUNË 20.5 KW
 Konsumi vjetor (Sikur te punojne me kohe te plote)
 $20.5 \times 20 \text{ ore/dite} \times 365 \text{ dite} = 149.650 \text{ Kw/h.}$
 $149.650 \text{ Kw/h} \times 16.8 \text{ lek/Kwh} = 2.514.120 \text{ leke/vit}$

Zgjidhja me ndertimin e depos 200 m^3 ne kodrat e Sovjanit, veç eleminimit te kesaj kostoje, ben furnizim me vete rrjedhje dhe nuk varet nga energjia elektrike (pjeserisht) dhe difektet e mundeshme.

Per funksionimin e kesaj skeme duhet ndertuar dhe nje linje dergimi $\varnothing 100$ nga Stacioni i Pompimit Sovjan deri ne depo dhe linje furnizimi nga depo ne linjen e ujesjellesit Sheqeras $\varnothing 110$. Skema e re garanton furnizim te plote te fshatit me nje sasi prej $170 \text{ l/banor ne dite}$.

Depoja e ujit.

Depoja e ujit do te ndertohet ne kuoten 880.00 m duke siguruar nje lartesi prej 65 m nga pika me e ulet ne fshat. Volumi i depos do te jete 200 m^3 .

$V \text{ depos} = 30\% \times Q \text{ ditore burimit} = 30\% \times 0.005 \text{ l/sek} \times 86400 \text{ sek} = 130 \text{ m}^3$

Volumi eshte projektuar per 200 m^3 per arsye te garantimit te furnizimit per nje kohe me te gjate.

Nga vezhgitet ne terren e formacioneve gjeologjike rezulton se ato jane formacione te mire dhe pa problem ne qendrueshmerine e objektit.

Per realizimin e projektit duhen patur parasysh kondicionet e meposhtme:

- Sasia e prurjeve $432 \text{ m}^3/\text{dite}$.
- Per ndertimin e ujesjellesit do te perdoren tubo polietileni PE PN 6 sipas Standarteve ISO, ne perputhje me Standartet Shteterore te Republikes se Shqiperise.
- Thellesia e germimit varion nga $1.1-1.2 \text{ m}$ dhe gjeresia 0.7 m sipas dimensionit te tubove.
- Tubacionet do te mbulohen me shtrese rere 20 cm pastaj me dhe natyral.
- Rakorderite e perdorura do te jene sipas standartit te tubove.
- Depoja e ndertuar me volum 200 m^3 eshte e mjaftueshme per te siguruar sasine e nevojshme per pikun e perdorimit te ujit.

Projektuesi pati parasysh qe ky investim te sherbeje per nje periudhe mbi 30 vjetesh. Me pas duhen studiuar burime te tjera furnizimi. Gjithashtu realizimi i ketij projekti i sherben permiresimit te kushteve higjeno-sanitare te banoreve.

Korçe Nentor 2018

PROJEKTUESI

Ing. Panajot PILANI

